

EU4SAFEALB



Funded by
the European Union



implemented by

ICMPD

International Centre for
Migration Policy Development

Buletini 1

MINISTRIA E BRENDSHME E SHQIPËRISË LUFTON KRIMIN E ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMIN E DROGAVE

Ministria e Brendshme (MB) e Shqipërisë është e angazhuar për rritjen e kapaciteteve operacionale të Policisë së Kufirit dhe Migracionit (PKM) për të luftuar krimin ndërkufitar, përfshirë trafikimin e drogave. Për këtë qëllim, janë ndër-marrë një sërë hapash brenda strukturave të MB-së gjatë viteve të fundit, të tilla si përmirësimi i procedurave të caktuara dhe rritja e cilësisë dhe kapaciteteve. Zonat e prekura përfshijnë kuadrin ligjor që duhet të përafrohet me praktikën më të mirë të BE-së dhe kapacitete të përmirësuara administrative dhe profesionale (përfshirë trajnimin, IT dhe infrastrukturën), në mënyrë që të përmirësohet organizimi dhe menaxhimi i agjencive kufitare, të cilat nga ana tjetër do të lehtësojnë shkëmbimet tregtare dhe do të rrisin cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, ndërsa do të pengojnë veprimtarinë e paligjshme përtej kufirit shtetëror dhe në këtë mënyrë do të rritet siguria e kufirit. Angazhimet strategjike të qeverisë së Shqipërisë për të forcuar kapacitetet e menaxhimit të kufirit janë pasqyruar gjithashtu në Strategjinë e re kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (Strategjia MIK) 2021-2027, e cila është aktualisht në zbatim. Mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Strategjia e re e MIK synon të sigurojë lëvizjen e sigurt të shtetasve dhe mallrave përtej kufirit shtetëror, si dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe goditjen e të gjitha formave të krimit ndërkufitar dhe migracionit të parregullt. Strategjia gjithashtu ofron një kuadër për agjencitë kombëtare të MIK që të çojnë përpara reformën dhe ta përafrojnë me praktikën e mira të BE-së, si edhe të përmbushin zyrtarisht kërkesat përkundëjt aspiratave për anëtarësim në BE. BE dhe shtetet anëtare të tij e kanë mbështetur Shqipërinë në këtë fushë për shumë vite, duke u përqendruar në përmirësimin gradual dhe sistematik të kapaciteteve institucionale dhe në ofrimin e asistencës teknike përmes fondeve IPA (Instrumenti i Ndihmës Para-Anëtarësimit). Në nivelin operacional, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e

Statusit mes BE-së dhe Shqipërisë, e cila bëri të mundur që Agjencia Europiane e Rojës Bregdetare dhe Kufitare (Frontex) të zhvillojë operacionin e saj të parë të përbashkët në territorin e një shteti jo anëtar të BE-së. Kohët e fundit, mes Frontex dhe autoriteteve shqiptare është nënshkruar një marrëveshje pune për të forcuar bashkëpunimin e tyre në menaxhimin e kufijve në lidhje me kthimin dhe për të luftuar krimin ndërkufitar. Projekti Mbështetje e BE-së për menaxhimin efektiv të kufijve të gjelbër dhe blu në Shqipëri (EU4SAFEALB) është një nga projektet e financuara nga BE që rrit kapacitetet e agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit për të luftuar krimin e organizuar dhe trafikimin e drogave, projekt ky që zbatohet nga Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migracionit (ICMPD). Agjencitë përfituese janë angazhuar të mbështetin ICMPD-në për zbatimin e projektit në të mirë të Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së.

BE MBËSHKET KAPACITETET E SHQIPËRISË NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Përmes projektit EU4SAFEALB, BE ofron pajisje moderne për mbikëqyrjen e kufirit dhe trajnim të specializuar për Policinë shqiptare të Kufirit dhe Migracionit. Kjo mbështetje do të rrisë më tej kapacitetet e Shqipërisë për të luftuar në mënyrë efektive krimin e organizuar përgjatë kufijve të saj kombëtarë. Vlera e projektit aktual është 6 milion EUR dhe është i fundit në linjën e projekteve të tjera mbështetëse të BE-së për Policinë dhe Doganat Shqiptare, që kapin shifrën më shumë se 20 milion EUR vetëm në pesë vitet e fundit. Puna e oficerëve të zbatimit të ligjit është thelbësore për përparimin e mëtejshëm në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Bashkimi Europian dhe Shqipëria qëndrojnë së bashku në luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar.

AKTIVITETET E PROJEKTIT



Në korrik të vitit 2020, projekti vlerësoi nevojat e Policisë së Kufirit dhe Migracionit (PKM) në lidhje me pajisjet dhe trajnimin, ndërsa raporti me gjetjet u miratua në dhjetor 2020. Në bazë të vlerësimit, PKM do të pajiset me anije patrullimi, mjete për mbikëqyrje dhe një sistem radari për mbikëqyrjen detare. Projekti përqendrohet në rritjen e kapaciteteve logjistike dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve të PKM. Gjithashtu, projekti do të ofrojë trajnime specifike për stafin e PKM-së, përfshirë trajnimin për mjetet e lundrimit për patrullim dhe operatorët e radarëve, për mirëmbajtjen bazë të mjeteve të lundrimit për patrullim, për mirëmbajtjen e sistemeve të specializuara të IT-së dhe mjeteve teknike. Për informacione të mëtejshme, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të ICMPD-së.




Takimi u drejtua nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe u bashkë-drejtua nga ICMPD me pjesëmarrjen e Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe PKM-së, organizatave ndërkombëtare (Frontex, IOM, OSBE, PAMECA) dhe donatorëve dypalësh që po mbështetnin Shqipërinë në fushën e menaxhimit të kufirit dhe luftës kundër krimit të organizuar. Anëtarët e KDP-së mbështetën raportin paraprak të projektit dhe dhanë komentet përfundimtare për listën e pajisjeve, e cila u miratua nga donatori menjëherë pas kësaj.

MBËSHTETJA E POLICISË FEDERALE GJERMANE PËR PKM

Që kur Policia Federale e Gjermanisë krijoi një Zyrë Ndërlidhëse në Shqipëri në vitin 2015 për të rritur bashkëpunimin dhe për të mbështetur PKM në luftën kundër migracionit të parregullt dhe krimit ndërkufitar, bashkëpunimi me të gjithë aktorët në Shqipëri, veçanërisht me BE-në si mbështetës kryesor, ka qenë i mirë. Policia Federale e Gjermanisë, ndër të tjera, ka qenë një nga donatorët më mbështetës të PKM-së dhe ka dhënë kontribut të konsiderueshëm vitet e fundit për të mbështetur detyrat efektive në kufirin e gjelbër duke furnizuar me mjete patrullimi, laboratorë dokumentesh dhe pajisje për mbikëqyrje. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të aftësive të patrullës dhe oficerëve të vijës së dytë duke ofruar kurse themelore dhe të avancuara trajnimi në fushën e sigurisë së dokumenteve. Për të shmangur përsëritjet ose mbivendosjen e mundshme të aktiviteteve, ICMPD ftoi oficerin e ndërlidhjes së Policisë Federale të Gjermanisë - nga drafti më i parë i projektit deri në vendimin përfundimtar - që të kontribuonte me përvojën e tij dhe të orientonte të gjitha aktivitetet e planifikuara për zhvillimin profesional të PKM. Bashkëpunimi do të vazhdojë brenda kuadrit të projektit dhe do të krijohen sinergji të qëndrueshme për ofrimin e trajnimit dhe ekspertizës së përbashkët.

TAKIMI I PARË I KOMITETIT DREJTUES TË PROJEKTIT



EU funded project EU Support for the Effective Management of Green and Blue Borders in Albania (EU4SAFEALB)

Takimi i parë i Komitetit Drejtues të Projektit (KDP) u zhvillua në internet më 12 Janar 2021. U prezantua progresi në zbatimin e projektit dhe u miratuan hapat e ardhshëm, në veçanti blerja e pajisjeve dhe ofrimi i trajnimit.

TENDERI I PARË I PROJEKTIT

Tenderi i parë që u zhvillua do të sigurojë mjete lundrimi me madhësi të ndryshme për patrullim, sisteme të mbikëqyrjes së lëvizshme dhe oficinën e lëvizshme për mirëmbajtje.

KONTAKTE

Z. Borut Eržen, Drejtues, Programi për Sigurinë dhe Menaxhimin e Kufirit, ICMPD
Gonzagagasse 1, 1010 Vienna, Austria
Telefon: +43 1 504 4677 2357
E-mail: borut.erzen@icmpd.org
Faqe interneti: www.icmpd.org

AKTIVITETE TË ARDHSHE TË PROJEKTIT

- Përgatitja dhe shpallja e tenderit të 2^{të} të projektit për prokurimin e sistemit të radarëve për mbikëqyrjen detare